



Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

RAPORT MBI VEPRIMTARINË E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE GJATË VITIT 2019

Tiranë, Shkurt 2020

Tabela e përmbajtjes:

KAPITULLI I	2
▪ <i>Vështrim i përgjithshëm</i>	2
▪ <i>Organet dhe funksionet e institucionit</i>	3
▪ <i>Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMShC-së</i>	4
KAPITULLI II	5
▪ <i>Zbatimi i Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" si dhe i Ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"</i>	8
▪ <i>Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 12 sipas fushave prioritarë si dhe shtrirjes territoriale</i>	10
▪ <i>Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese</i>	12
KAPITULLI III	16
▪ <i>Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)</i>	16
KAPITULLI IV	18
▪ <i>Monitorimi/Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetore për Vitin 2019</i>	18
▪ <i>Plani fillestar i Buxhetit Viti 2019</i>	18
▪ <i>Rishikimi i Buxhetit për Vitin 2019 si dhe ndryshimet e ndodhura nga plani fillestar</i>	19
▪ <i>Analiza e realizimit të treguesve buxhetorë për Vitin 2019</i>	21
▪ <i>Ecuria e disbursimeve të granteve financiare</i>	22
KAPITULLI V	27
▪ <i>Aktivitetet kryesore të AMShC-së për vitin 2019</i>	27

KAPITULLI I

Vështrim i përgjithshëm

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është një ent publik, buxhetor krijuar me Ligjin me nr. 10093 datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile".

AMShC-ja është krijuar me qëllimin për të asistuar me Mbështetje Financiare dhe Teknike Shoqërinë Civile në vend duke qenë e përkushtuar të promovojë, mbështesë dhe mbrojë parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, mos-diskriminimit, sundimit të ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, transparencës dhe profesionalizmit.

Një shoqëri civile aktive, e fuqishme dhe gjithë përfshirëse mund të luajë një rol të rëndësishëm për zbatimin në praktikë të këtyre parimeve. Ajo është gjithashtu një komponent thelbësor i çdo demokracie funksionale.

Duke artikuluar shqetësimet e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile, si subjekte jo- shtetërorë, struktura jo-fitimprurëse, në të cilat njerëzit organizohen të ndjekin objektivat dhe idealet e përbashkëta, duhet të jenë gjithnjë e më shumë aktivë për çështje publike si dhe të angazhohen në iniciativa që nxisin pluralizmin dhe pjesëmarrjen në demokraci.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në kuadër të politikës së fuqizimit të shoqërisë civile, është përqendruar në stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe gjithë përfshirëse.

Kjo reflektohet në përpjekjet për krijimin e një mjedisi që është i favorshëm për aktivitetet e shoqërisë civile dhe ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve për të qenë aktorë të efektshëm, të përgjegjshëm dhe të pavarur, nëpërmjet formalizimit të procedurave transparente dhe jo-diskriminuese të regjistrimit, veprimtarisë së lirë dhe të pavarur, si dhe bashkëpunimit midis qytetarëve etj.

Shoqëria civile, duke pasur struktura të përshtatshme dhe mekanizma për bashkëpunim me AMShC-në dhe institucionet e tjera publike, si dhe fluks të lirë, të qartë dhe të arritshme të informacionit mbi çështjet e interesit publik përmes mekanizmave të qëndrueshme dhe të strukturuar, rrit autonominë e saj, atë të përfaqësimit dhe të llogaridhënies, duke forcuar bazën e organizatave sipas standardeve më të larta të qeverisjes së brendshme, nëpërmjet përfshirjes së strukturave demokratike, monitorimit dhe vlerësimit, menaxhimit financiar, transparençës, informimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Organet dhe funksionet e institucionit

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është krijuar me Ligjin nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe ka si mision të saj, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për përmbushjen e këtij misioni, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si detyrë të saj funksionale që të ofrojë asistencë financiare dhe teknike për programet që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse; bashkëpunimin ndër-sektorial e ndërkombëtar; nismat civile; filantropi; vullnetarizmin e institucioneve demokratike të shoqërisë civile; si dhe programe të tjera, që lehtësojnë përmbushjen e misionit të saj.

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *nxitjen e bashkëpunimi me OJF-të, që kanë objekt të punës mbikëqyrjen e luftës kundër korrupsionit; luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të trajtimit të viktimave të saj; kundër dhunës në familje e kundër dhunës ndaj fëmijëve;*
- *nxitjen e qytetarëve në veprimtari, përfshirja e pjesëmarrja e tyre për zhvillimin e komunitetit;*
- *respektimin e të drejtave të njeriut;*
- *krijimin e konsolidimin e kapaciteteve të shoqërisë civile;*
- *zhvillimin e bashkëpunimit ndër sektorial dhe e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile;*
- *rritjen e ndikimit publik dhe veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile në vendimmarrje;*
- *zhvillimin e sipërmarrjes shoqërore dhe punësimit në sektorin jofitimprurës;*
- *rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike*
- *përcaktimin e procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile etj.*

Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMShC-së

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile funksionon dhe mbështet punën e saj duke u bazuar në një paketë të plotë ligjore, si vijon:

- a) Ligji me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ky ligj, deri më sot nuk ka pësuar asnjë ndryshim.
- b) Vendimi nr. 769 datë 15.07.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- c) Vendimi nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- ç) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 20.09.2010.
- d) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e azhurnuar në përputhje dhe përshtatje me ndryshimet e parashikuara në Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Këto ndryshime janë miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 30.11.2011.
- dh) Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile” të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës me Vendimin nr. 1 datë 08.07.2010.
- e) Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile”, e ndryshuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 10.03.2011.
- ë) Vendimi nr. 1 datë 08.07.2010 i Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, nëpërmjet të cilit janë miratuar:
 - Formati i Aplikimit.
 - Kriteret e Vlerësimit.
 - Kontrata Tip
- f) Udhëzimin nr. 1 datë 29.12.2010 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për plotësimin e raporteve financiare dhe kontrollin financiar, për efekt të monitorimit të Projekteve të financuara me Grante nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- g) Urdhri nr. 161 datë 05.09.2013 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për procedurën e administrimit të akteve shkresore, kërkesave/projekt-propozimeve, formimin e dosjeve dhe mënyra e qarkullimit të tyre në AMShC”.

KAPITULLI II


Programi Anti-Korrupsion kornizohet ligjërisht përmes akteve të miratuara nga Qeveria Shqiptare të cilat, në vetvete, sanksionojnë dhe rregullojnë veprimtarinë e Organit Qendror (AMShC-së) sipas parashikimeve të publikuara. Kjo kornizë ligjore shkon paralel me akte të tjera ligjore të cilat nuk çënojnë në zbatimin e tyre zbatimin e misionit të AMShC-së në thelb. E thënë konkretisht, ky program, është pikë zbatimi i një programi umbrellë i cili inicon dhe vijon prej Kryekoordinatorit të tij – Ministria e Drejtësisë.

Vendimi Nr. 247 datë 20.03.2015 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për Periudhën 2015-2020” i Këshillit të Ministrave, pasqyron qartë gjëndjen në të cilën ndodhet korrupsioni dhe objektivat për realizim të kësaj strategjie të cilat do të ndihmojnë të minimizojnë këtë fenomen në të ardhmen.

Për t’i ardhur në ndihmë kësaj nisme por edhe referuar nevojave të ndryshme të adresuara në këtë prizëm, Qeveria Shqiptare, me Vendimin Nr. 241 datë 20.04.2018 “Për Miratimin e Planit të Veprimit 2018-2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së Indikatorëve, Krijimin, Funksonimin dhe Detyrat e Komitetit Koordinator për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020 dhe Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion”.

Ky vendim i fundit, qartëson edhe më tej planin konkret të Institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Antikorrupsion duke specifikuar konkretisht Objektivat të cilat i gjejmë në sistemin grafik të mëposhtëm:

Grafiku Nr. 1



Siç mund të shikohet qartë, në mënyrë të përmbledhur do të kemi: 18 objektiva në total të ndara në qasjet Parandaluese, Ndëshkuese dhe Ndërgjegjësuere. Për të arritur këto objektiva, do të duhet të merren 97 masa të ndara sipas objektivit përkatës dhe fund, do të duhet të zbardhim 37 indikatorët për masat e ndërmarra në funksion të arritjes së objektivave sipas qasjes.

AMShC, është angazhuar në arritjen e Objektivit C3 ***“Inkurajimi i Bashkëpunimit me Shoqërinë Civile”***.

Ky objektiv, parashikon për AMShC-në:

- 1. Krijimin e një programi antikorrupsion;***
- 2. Financimin e projekteve me objektiv specifik- këtë program dhe***
- 3. Promovimin e bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile të cilat fokus të krijimit të tyre kanë korrupsionin dhe luftën kundër tij.***

Krijimi i programit antikorrupsion është proces vijues i hartimit të vendimit të brendshëm për këtë akt zbatimi i të cilit do të zhvillohet paralelisht me thirrje për financime për projekt- propozime me në qendër luftën kundër korrupsionit, luftën ndaj tij dhe organizimin e fushatave sensibilizuese ndaj këtij fenomeni.

Lidhur me financimin e projekteve, AMShC, përgjatë vitit 2019, mundësoi financimin e nëntë projekteve me objekt specifik, luftën kundër korrupsionit. Asistenca financiare e këtyre projekteve, arriti vlerën e 20,800,000 (njëzetë milionë e tetëqind mijë) lekë përkundër parashikimit për financim në vlerën e 20% të grantit në tërësi.

Arsyeja që aktorë të shoqërisë civile në Shqipëri, janë përfshirë në Strategjinë kundër Korrupsionit është se ekspertiza e realizuar nga ekspertët, shfaq nivelin e lartë të këtij fenomeni në çdo fushë të rendit shoqëror.

❖ Krijimi i Infrastrukturës për Denoncime

AMShC- ja, si Institucion për zbatimin e masave të parashikuara, në emër dhe për llogari të saj, ashtu siç edhe janë përmendur më herët, parashikon veprime të cilat, paralelisht me ushtrimin e funksioneve të saj, do të ndikojnë në plotësimin dhe pasqyrimin e plotësimin të objektit të krijimit dhe angazhimit të ndërmarrë.

Thënë sa më sipër, AMShC, ka ndërmarrë një sërë hapash dhe veprimesh lidhur me infrastrukturën e nevojshme për denoncimin e aktit të korrupsionit duke ofruar shumë lehtësira në funksion të denoncuesve në përllogaritje të moshave të ndryshme eventuale të cilat denjojnë të shprehin haptazi një akt korruptiv qoftë edhe në perceptim.

Kjo infrastrukturë përbëhet nga tre angazhime të cilat shpalosen si më poshtë:

1. Instalimi i Numrit të Dedikuar Call Center

Ndër angazhimet e para të ndërmarrë nga AMShC është instalimi i numrit të dedikuar të telefonit lëvizës enkas për denoncimin e rasteve korruptive në fushën e veprimtarisë së shoqërisë civile. Pavarësisht problemeve burokratike shtetërore në funksion të instalimit të këtij numri dhe mënyrës së përzgjedhjes së tij, sot, AMShC zotëron numër të dedikuar për denoncimin e rasteve korruptive. Numri i dedikuar është disponibël në çdo orë të ditës dhe të natës me qëllim që denoncuesit të kenë akses të plotë në denoncimin e rasteve edhe në kohë reale. Numri i është caktuar për përdorim personit përgjegjës të kontaktit të Institucionit për Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit ku si detyrë kryesore

është përpilimi i një draft-raporti lidhur me numrin e denoncimeve në çdo ditë të fundit të javës pranë titullarit të Institucionit.

2. Krijimi i Portalit Anti-Korrupsion

Në vazhden e angazhimeve Institucionale, AMShC krijoi edhe portalin anti-korrupsion në nivel elektronik duke hartuar mënyrën dhe formën e denoncimit të akteve të korrupsionit në veprimtarinë e shoqërisë civile. Kështu, është hartuar adresa elektronike duke referuar publikimin e saj në mediat sociale të krijuara për AMShC-në. Me instalimin final të këtij portali, AMShC, pretendon të jetë ndër Institucionet e para të cilat, me seriozitet, ofrojnë aksesin e publikut në vendimmarrje dhe politikbërje institucionale.

3. Organizimi i takimeve të vazhdueshme

Përgjatë vitit 2019 por edhe më tej, bazuar në parashikimin e planit të veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, AMShC, ka implementuar takime informuese me aktorë të shoqërisë civile në rrethe të ndryshme të vendit. Qëllimi i këtyre takimeve informuese, është jo vetëm informimi i publikut me masat e parashikuara nga dhe në emër të AMShC-së por, edhe informimi i tyre lidhur me Strategjinë në tërësi, masat e parashikuara nga Institucionet, raportet e zbardhura deri në momentin e zhvillimit të takimeve si dhe, nevojën për rishikueshmërinë e kësaj strategjie, bazuar në nevojat reale dhe të marra ballë për ballë me shoqërinë civile si pala e impaktuar nga kjo strategji për këtë prioritet.

❖ Përmirësimi i Kapacitetit Institucional

AMShC-ja, është objekt i vazhdueshëm i pjesëmarrjes në trajnime dhe konferenca të ndryshme që realizohen nga subjektet shtetërore dhe ndërkombëtare.

Qëllimi i pjesëmarrjes është përthithja e ideve inovative me fokus përmirësimin e ambientit të shoqërisë civile në Shqipëri.

Në eksperiencat e saj, AMShC, përherë është treguar e gatshme të përvetësojë ato më të mirat duke zbatuar sugjerimet dhe komentet e trajnuesve në procedurat dhe hapat e saj sipas parashikimeve.

❖ Plani i Veprimit:

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është organ zbatues i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Përgjegjësia e zbatimit të planit të punës, i referohet objektivit C.3 “Inkurajimi i Bashkëpunimit me Shoqërinë Civile” që i përket Qasjes Ndërgjegjësuese.

Plani i veprimit, është objekt i ndryshimeve varësisht nevojave dhe situatave qeveritare me qëllim, ofrimin e një plani masash gjithëpërfshirës dhe sa më pranë organizatave joqeveritare. Për vitet 2019-2020, AMShC-ja, ka parashikuar një sërë masash realizimi i të cilave do të ndihmojë në arritjen e objektivave të synuar.

Më poshtë do të sjellim në formë tabelore masat/aktivitetet e parashikuara në funksion të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit:

Tabela Nr. 1

Nr.	Masa/ Aktiviteti	Vlera	Afati
1	Mbështetje Financiare për Projekte që synojnë ndërgjegjësimin e publikut dhe ofrojnë asistencë në denoncimin e rasteve korruptive	20,200,000 mln <u>+20,200,000</u> 40,400,000	2019 2020
2	Realizimi i Seancave Informuese me aktorë të shoqërisë civile lidhur me prezantimin e masave dhe arritjeve	200,000 <u>+200,000</u> 400,000	2019 2020

Zbatimi i Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" si dhe i Ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"

❖ Zbatimi i Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI). Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës AMSHC ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet.

Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje.

Faqja zyrtare e AMSHC-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

❖ Zbatimi i Ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

Në kuadër të këtij Ligji, AMSHC-ja ka kryer takime konsultative për periudhën 2019:

1. Takime konsultative me Organizata të Shoqërisë Civile në lidhje me Strategjinë 2015-2020 të AMSHC-së
2. Takime konsultative me Organizata të Shoqërisë Civile mbi Draftin e UDHËRRËFYESIT të Rishikuar

3. Takime konsultative me Organizata të Shoqërisë Civile mbi procesin e zgjedhjes së anëtarëve të rinj të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC)
4. Takime konsultative me Organizata të Shoqërisë Civile lidhur me Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020: Objektivi C.3: Inkurajimi i Bashkëpunimit me Shoqërinë Civile;
5. *Organizimi i një procesi online të hapur konsultativ me shoqërinë civile me qëllim marrjen e feedback-ut mbi përcaktimin e fushave prioritare të thirrjes së radhës duke konsideruar prioritetet e parashikuara me ligj.*

Në këtë llogjikë për përcaktimin e fushave prioritare për thirrjet për projekt propozime me qëllimin për të marrë vërejtje dhe sugjerime nga shoqëria civile, AMSHC-ja para çdo thirrje ka organizuar Takime Konsultative me shoqërië civile, për të qenë një instrument lehtësues i dialogut midis shoqërisë civile dhe institucioneve. Krahas takimeve konsultative për të ndihmuar procesin pra dhënien e mendimeve nga aktorët e shoqërisë civile, j'u është shpërndarë paraprakisht një pyetësor i shkurtër të gjitha organizatave të cilat janë në bazën tonë të të dhënave, i cili ka qenë online në faqen tonë zyrtare: www.amshc.gov.al

Me synim konsultimin publik në lidhje me prioritetet e Thirrjes së radhës Nr. 12 si dhe në kuadër të një bashkëpunimi sa më të frytshëm e të suksesshëm midis AMSHC-së, Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Pushtetit vendor, u organizuan takimet konsultative në qytetet Korçë, Gjirokastrë, Peshkopi, Vlorë, Kukës, Shkodër dhe Tiranë nën moton: **“Fuqizohemi së bashku”**.

Në këto takime përfaqësuesit e AMSHC-së parashtruan çështjet kryesore për të cilat u organizuan takimet, që ishin:

- *Sfidat dhe prioritetet e sektorit të Shoqërisë Civile për secilin qark dhe më konkretisht, sa nga OJF-të e regjistruara janë aktive në qytete dhe zonat përreth, të cilat kontribuojnë për zgjidhjen e këtyre sfidave*
- *Marrja e një feedback-u për problematikat e ndryshme dhe sugjerimet për mbështetje financiare, për zgjidhjen e tyre nëpërmjet kontributit të Shoqërisë Civile*
- *Nxjerrja e fushave prioritare të cilat duhet të përfshihen në thirrjen e radhës, të propozuara nga pjesëmarrësit, përfaqësues të Shoqërisë Civile.*

Në takimet e organizuara si dhe nga shqyrtimi i të gjitha materialeve të marra në rrugë elektronike dhe në formë të shkruar (*hard copy*), ku përfaqësuesit e OJF-ve, pushtetit vendor dhe grupeve të tjera të interesit listuan të gjitha sugjerimet e tyre si më poshtë:

1. *Mbështetja e projekteve për mbrojtjen e mjedisit me fokus pyjet dhe vendburimet termale; Fokusim dhe adresim i dëmeve të shkaktuara gjatë tranzicionit dhe në vijim në hapësirat detare dhe bregdetare shqiptare*
2. *Zhvillimi i turizmit dhe kryesisht atij familjar duke pasur parasysh prodhimet tradicionale të zonës*
3. *Arti dhe trashëgimia kulturore; aktivizimi i brezave të rinj për të ruajtur trashëgiminë dhe identitetin tonë kulturor*
4. *Zbatimi i metodës LEADER nëpërmjet krijimit dhe fuqizimit të Forumeve rurale, për të nxitur lobim, advokaci dhe përfaqësim të komuniteteve në zonat rurale, kryesisht malore dhe të defavorizuara*
5. *Mbështetje për medien investigative lokale*
6. *Korrupsioni dhe lufta kundër tij*

7. *Mirëqeverisja vendore*
8. *Monitorimi i Reformës në Drejtësi dhe procesit të vetingut*
9. *Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve*
10. *Bashkëveprimi i rinisë në fushatat sensibilizuese për promovimin e talenteve të reja në art, kulturë dhe skulpturë*
11. *Mbështetje dhe aksesueshmëria për personat me aftësi ndryshe, përfshirja sociale e personave me aftësi intelektuale*
12. *Sensibilizim, mobilizim dhe aktivizim i të rinjve në proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia*
13. *Sensibilizimi i të rinjve në përdorimin e masave mbrojtëse nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme*
14. *Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, kryesisht në zonat rurale*
15. *Mbështetje për arsimimin profesional, fuqizimin dhe punësimin e grave e të rinjve*
16. *Identifikim, adresim dhe zhvillim të zonave rajonale natyrore me potenciale turistike të riskuara nga zhvillimet ekonomike të pakontrolluara*
17. *Promovimi i harmonisë dhe bashkëjetesës fetare*
18. *Përmirësimi i shërbimeve sociale*
19. *Mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë*
20. *Rritja e kapaciteteve të OJF-ve për hartimin e projekteve konkrete, sidomos atyre lokale.*

Nga bashkëbisedimet me përfaqësuesit e pushtetit vendor u vërejt gatishmëri për bashkëpunim institucional si dhe ofrimin e fasiliteve dhe mbështetjes për implementimin e projekteve të OJF-ve.

Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 12 sipas fushave prioritarë si dhe shtrirjes territoriale

Fushat e prioritetëve të Thirrjes Nr. 12:

1. Rinia - Investim dhe garanci për të ardhmen evropiane të vendit

- Fuqizimi i kapaciteteve për sipërmarrje në fusha të ndryshme zhvillimit (promovimi i produkteve vendase, zhvillimi i turizmit rural dhe urban, historike, kulturore, etnografike, folklorike, etj.)
- Aktivizimi i grupeve studentore të ekselencës në programe të studimeve shkencore, inovative etj.
- Rinia në tregun e vlerave (art, kulturë, inovacion etj.), ura bashkëpunimi mes gjeneratave Rinia dhe Moshë e tretë (shkëmbim eksperiencash, diskutime miqësore, histori nga e kaluara etj.)
- Rinia në fokusin gjithpërfshirës në garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm
- Tryeza sensibilizimi dhe diskutimi, nisma për zhvillimin e aktivizimit dhe vullnetarizmit, pjesëmarrjes, sipërmarrjes, partneritet, arsimin, aftësimin profesional etj.

2. Integrimi - Shoqëria civile si faktor, aktor dhe partner i rëndësishëm në proceset e integrimit evropian dhe rajonal të vendit

- Sensibilizim, fuqizim kapacitetesh për një mjedis mundësues në proceset integruese

- Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj.
- Mirëqeverisja (Pushteti Qendror dhe Lokal), transparenca, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, përgjegjshmëria dhe integriteti, reforma në drejtësi, rritje kapacitetesh, inovacion, monitorim, partneritet etj.
- Fuqizim kapacitetesh në ideim, shkrim, zbatim, monitorim dhe raportim të projekteve për shoqatat rinore, rurale, të sapokrijuara; aplikimi i metodës LEADER etj.
- Edukim qytetar në funksion të proceseve integruese (familja, shkolla, komuniteti, biznesi, institucionet shtetërore etj.)

3. Zhvillimi Social, shërbimet sociale

- Partneritet me grupet në nevojë në fuqizim kapacitetesh etj.
- Mbështetje për grupet në nevojë (persona të dhunuar; grupe të traumatizuara; fëmijët e braktisur; të ngjuarit; etj.), parandalimi i konfliktit dhe dhunës; asistencë psikologjike; zgjidhje paqësore e konflikteve, mbrojtja nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme etj.
- Fuqizimi/Diversifikimi i shërbime sociale për grupet në nevojë në garantimin e të drejtave të njeriut, në të gjithë spektrin e jetës politike, ekonomike, kulturore, sociale etj.

4. Mjedis, Turizmi dhe Zhvillimi i qëndrueshëm


- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmytjet, zjarret, tërmete etj.)
- Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe konkurrues i zhvillimit të qëndrueshëm
- Promovimi dhe ruajtja e vlerave historike, etnografike, turistike, artistike, kulturore, guidat turistike, koleksionistët, tolerancës fetare etj. si vlera historike e kombit shqiptar dhe detyrim ndaj brezave të ardhshëm

Statistikisht shpërndarja e projekteve nën secilin prioritet strategjik paraqitet sipas Tabelës së mëposhtme:

Tabela Nr. 2

Nr.	Fushat Prioritare	Nr. Projekteve	Financimi për secilin prioritet (në lekë)	Pesha Specifike (në %)
1	Rinia - Investim dhe garanci për të ardhmen evropiane të vendit	12	24,600,000	21.30
2	Integrimi - Shoqëria civile si faktor, aktor dhe partner i rëndësishëm në proceset e integrimit evropian dhe rajonal të vendit	9	20,600,000	17.80
3	Zhvillimi Social, shërbimet sociale	4	8,700,000	7.50
4	Mjedis, Turizmi dhe Zhvillimi i qëndrueshëm	10	24,200,000	20.90
5	Më shumë se një fushë	17	37,500,000	32.40
Total		52	115,600,000	100

Grafiku Nr. 2



Siç mund të vërehet nga tabela dhe grafiku, prioriteti me përqindjen më të lartë të projekteve të zbatuara është ai nën kategorinë “Rinia – Investim dhe garanci për të ardhmen evropiane të vendit” me një peshë specifike 21.3% që do të thotë që nën këtë prioritet projektet implementuese dhe vetë OJF-të i kanë venë theksin gjithnjë e më shumë te rinia si një faktor tepër i rëndësishëm i shoqërisë shqiptare si një investim dhe garanci për shoqërinë evropiane ku dëshirojmë të aderojmë.

Një zë tjetër i rëndësishëm i përqindjes së peshës specifike përbën dhe mjedisi si dhe zhvillimi të qëndrueshëm të tij.

Ndërkaq, kategoria më shumë se një prioritet/fushë në përgjithësi nga statistikat ka qenë një kategori që gjithnjë ka pasur një përqindje të lartë, pasi projektet kanë qenë të një natyre më të gjerë, por që për këtë thirrje kjo kategori është në përqindjedje më të ulur krahasimisht me vitet e tjera. Pra projektet kanë qenë më të orientuar në një prioritet të caktuar.

Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në mënyrë të vazhdueshme duke qenë se në filozofinë e saj e misionin e saj ka një shpërndarje të projekteve fituese sa më të gjerë në të gjithë territorin. Në të njëjtën përfaqëse edhe në thirrjen e saj Nr. 12 të drejtuar OJF-ve për shprehje interesi për Projekt Propozime e ka pasur si objekt kryesor një shpërndarje territoriale sa më të gjerë në nivel kombëtar. Siç mund të vihet re nga të dhënat tabelave/grafikëve si dhe shpërndarjes në përqindje; por edhe asaj territoriale, Projektet fituese kanë një përqëndrim më të lartë të zbatueshmërisë në rrethin e Tiranës.

Mbulimi për financim me projekte në përgjithësi prek të gjitha qarqet administrative. Mbulimin me përqindje më të lartë siç u përmend dhe më lartë e zë Qarku i Tiranës, më pas vijne qarqet Berat; Vlorë; Gjirokastrë Elbasan, Durrës, Korçë etj. Në mënyrë më të detajuar për këtë shpërndarje të dhënat shprehen në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm.

Tabela Nr. 3

Shpërndarja Territoriale e projekteve fituese për Thirrjen 12

Nr.	Shtrirja në Nivel Qarku dhe Kombëtar	Nr. i projekteve fituese
1	Qarku i Beratit	3
2	Qarku Dibër	2
3	Qarku Durrës	3
4	Qarku Elbasan	5
5	Qarku Fier	3
6	Qarku Gjirokastrë	3
7	Qarku i Korçë	5
8	Qarku Kukës	2
9	Qarku Lezhë	2
10	Qarku Shkodër	4
11	Qarku Tiranë	11
12	Qarku Vlorë	4
13	Projekte në Nivel Kombëtar	5

Grafiku Nr. 3

Shpërndarja Territoriale e projekteve fituese për Thirrjen 12





Tabela Nr. 4

Shpërndarja Territoriale e projekteve fituese për Thirrjen 12 sipas qyteteve

Nr.	Shtrirja në Nivel Qarku, Qyteti dhe Kombëtar	Nr. i projekteve fituese
1	Qarku i Beratit	3
1.1	Berat	3
1.2	Kucovë	0
1.3	Skrapar	0
2	Qarku Dibër	2
2.1	Peshkopi	2
2.2	Bulqizë	0
2.3	Mat	0
2.4	Klos	0
3	Qarku Durrës	3
3.1	Durrës	3
3.2	Krujë	0
4	Qarku Elbasan	5
4.1	Elbasan	3
4.2	Gramsh	0
4.3	Librazhd	1
4.4	Peqin	0
4.5	Prrenjas	1
4.6	Cerrik	0
5	Qarku Fier	3
5.1	Fier	2
5.2	Lushnje	1
5.3	Mallakastër	0
5.4	Roskovec	0
6	Qarku Gjirokastër	3
6.1	Gjirokastër	2
6.2	Përmet	1
6.3	Tepelene	0
7	Qarku i Korçë	5
7.1	Korçë	3
7.2	Devoll	0
7.3	Pogradec	1
7.4	Kolonje	0
7.5	Maliq	1
7.6	Pustec	0
8	Qarku Kukës	2
8.1	Kukës	1
8.2	Tropojë	1
8.3	Has	0
9	Qarku Lezhë	2
9.1	Lezhë	2
9.2	Kurbini	0
9.3	Mirditë	0
10	Qarku Shkodër	4
10.1	Shkodër	2
10.2	Puke	2
10.3	Malësi e Madhe	0
10.4	Vau i Dejës	1
10.5	Fush-Arrëz	0
11	Qarku Tiranë	11

11.1	Tiranë	9
11.2	Kamëz	1
11.2	Kavajë	1
11.4	Vore	0
12	Qarku Vlorë	4
12.1	Vlore	4
12.2	Sarande	0
12.2	Delvine	0
12.4	Selenice	0
12.5	Himarë	0
12.6	Finiq	0
12.7	Konispol	0
13	Projekte në Nivel Kombëtar	5

Grafiku Nr. 4
Shpërndarja Territoriale e projekteve fituese për Thirrjen 12 sipas qyteteve



KAPITULLI III

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Referuar nevojave dhe synimit për përafrimin e legjislacionit por jo vetëm, edhe strukturave shtetërore për funksionim edhe më të saktë të shoqërisë civile, Qeveria Shqiptare ndërmorri iniciativën për themelimin dhe organizimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Misioni themelor i këtij Këshilli do të jetë garantimi i bashkëpunimit institucional me organizatat e shoqërisë civile në dobi dhe në funksion të zgjerimit të demokracisë.



Në vazhden e kësaj nisme, Qeveria Shqiptare, në fundvitin e 2015-ës, miratoi Ligjin Nr. 119/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.

Përgjatë vitit 2019, Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC):

- Më datë 15 mars 2019, ora 09:30, pranë ambjenteve të Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD), në Kryeministri u mbajt takimi i përbashkët pune i Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri dhe Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) me temë “Open Government Partnership Visit to Albania”. Ky event organizohet në kuadër të angazhimit të marrë nga Qeveria Shqiptare për të qenë pjesë e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (Open Government Partnership – OGP) dhe vizitës së përfaqësuesve të lartë të OGP-së z. Joe Powell, Zëvendës drejtori Ekzekutiv dhe znj. Sandra Pernar, Koordinatore e Lartë Rajonale për Evropë.
- Në mbështetje të Ligjit Nr. 119/ 2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” dhe Rregullores mbi Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), organizoi procesin e zgjedhjeve për katër anëtarë nga Shoqëria Civile, vakanca të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 1-vjeçare. Ky process përfundoi me sukses duke shpallur më datë 28 qershor 2019 emrat e katër anëtarëve të rinj të zgjedhur nga procesi i votimit *online*:
 - **Për fushën e veprimit B.**
“Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor”
 - **Shpëtim MYRTO**
 - **Për fushën e veprimit C.**
“Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”
 - **Fabiola LAÇO – EGRO**
 - **Atrida FERKETI**
 - **Indrit SEFERI**

- Më datë 23 shtator 2019, pranë ambjenteve të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) u zhvillua një takim pune me anëtarë të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC). Takimi u zhvillua për të diskutuar për çështjet e mëposhtme:
 - Prezantimi i katër anëtarëve të rinj të zgjedhur;
 - Monitorimi i zbatimit të “Udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023” të rishikuar të miratuar;
 - Diskutim mbi organizimin e Konferencës së Parë Kombëtare të Shoqërisë Civile, ku të ballafaqohen përfaqësues të shoqërisë civile me përfaqësues të Qeverisë dhe komunitetit të donatorëve në lidhje me sfidat e këtij sektori;
 - Diskutim mbi agjendën dhe organizimin e mbledhjes së Këshillit si dhe propozimi i caktimit të një date.

- Më datë 12 nëntor 2019, mbahet mbledhja e radhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), e cila u organizua nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), pranë ambjenteve të Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD), në Kryeministri, ku kishte të ftuar organizata të shoqërisë civile.

Në këtë mbledhje u miratua Procesverbali i Mbledhjes së KKShC-së, të mbajtur më datë 22.6.2018; u diskutua mbi ndarjen e detyrimeve, ecurinë e KKShC-së në vazhdim dhe angazhimin e saj në monitorimin e VKM-së Nr. 539, datë 25.7.2019; Përfshirja e Shoqërisë Civile në Procesin e Negociatave; Organizimi i Konferencës së parë Kombëtare për Shoqërinë Civile; Ngritja e Grupit të Punës lidhur me Vullnetarizmin.

KAPITULLI IV

Hyrje

Në mbështetje të nenit 104 pika 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), në zbatim të Ligjit Nr.99, datë 03.012.2018 “Për Buxhetin e Vitit 2019” si dhe në kuadër të Udhëzimit Plotësues nr.1 datë 17.01.2019 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2019”, ju paraqesim Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për Agjencinë për Mbështetje të Shoqërisë Civile për Vitin 2019.

Monitorimi/Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetore për Vitin 2019

Siç edhe dihet, Monitorimi në këtë rast është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Pra, monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Me anë të këtij relacioni/raporti monitorimi të Buxhetit të AMShC- së për Vitin 2019, saktësojmë informacionin mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për Vitin 2019 përsa i përket **Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile**. Në përdorimin e fondeve buxhetore, AMShC-ja është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor.

Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat ekonomike dhe prioritetet e AMShC-së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara nga Agjencia për Mbështetje të Shoqërisë Civile për vitin 2019.

Plani fillestar i Buxhetit Viti 2019


Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në mbështetje të **Ligjit Nr. 99, datë 03.012.2018 “Për Buxhetin e Vitit 2019” si dhe në kuadër të Udhëzimit Plotësues nr.1 datë 17.01.2019 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2019”**, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, i është akorduar një fond i planifikuar prej **124 milionë lekë**, i detajuar si më poshtë nga:

Tabela Nr. 5

Fondi i Pagave	(zëri 600)	13,800,000	Lekë
Fondi i Sigurimeve Shoqërore	(zëri 601)	2,700,000	Lekë
Fondi për Shpenzime Operative	(zëri 602)	5,500,000	Lekë
Fondi për transfertat ndaj të tretëve	(zëri 604)	101,000,000	Lekë
Fondi për Investimet e Trupëzuara	(zëri 231)	1,000,000	Lekë
TOTAL		124,000,000	Lekë

Grafiku Nr. 5

Plani fillestar i Buxhetit – Viti 2019 (në lekë)



Duke vlerësuar konstatimet dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave përsa i përket Përgatitjes së Fazës së Parë të PBA-së 2019-2021, vlerësojmë se Ekipi i Menaxhimit të Programit gjatë vitit 2019, ka bërë një punë serioze dhe të përgjegjshme në drejtim të respektimit të përcaktimeve të udhëzimit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm përshtatur specifikisht për natyrën e detyrave dhe përgjegjësi që AMSHC mbulon në bazë të Ligjit mbi të cilin është krijuar dhe funksionon prej shumë vitesh tashmë.

- Së pari, në kuadër të pikës 3 të Udhëzimit nr.10, dt.28.02.2017 “Përfshirja e shoqërisë Civile në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”, ju vemë në dijeni se pjese e planeve të punës në baza vjetore për AMSHC-në, është gjithmone realizimi i takimeve konsultative me përfaqësues të Shoqërisë Civile në Shqipëri me qëllim njohjen me problematikat e hasura, me sugjerimet e tyre lidhur me organizimin e punës në Institucion, sugjerimet e tyre përsa i përket detajimit të zërave buxhetore si dhe përsa i përket aktiviteteve që janë të rëndësishme për t’u organizuar me qëllim përcjelljen e *feedback* të qartë të OJF-ve në punën tonë të përditshme si Institucion që mbështet fuqizimin e një Shoqërie Civile të qënësishme në vend.
- Së dyti, në vijim të punës për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor, edhe AMSHC-ja përcaktuar produkte/objektiva/aktivitete/kosto të detajuara për arritjen e barazisë gjinore si dhe ka financuar dhe ndjekur projekte me këtë qëllim.

Rishikimi i Buxhetit për Vitin 2019 si dhe ndryshimet e ndodhura nga plani fillestar

Gjatë vitit buxhetor 2019 nuk ka pasur ndryshime të Buxhetit fillestar përveç shtimit në llogarinë 606 të 30,000 lekëve për rast shpërblimi stafi për dalje në pension duke bërë që në fund të vitit 2019 plan thesari përfundimtar për Agjencinë për Mbështetje të Shoqërisë Civile të jetë **124,030,000 leke**.

Risia per detajimin e buxhetit te ketij viti ka qene detajimi ne dy produkte i buxhetit akorduar AMShC-se, te tilla si **98801AA** si dhe **98801AB** ku produktet te parashikuara ne PBA e Vitit 2019 sipas formateve te reja kane qene dy te tilla si: *Projekte te financuara nga AMShC-ja si dhe Monitorime/Inspektime ne terren.*


❖ Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile”

Tabela Nr. 6

Ecuria e realizimit buxhetor për vitin 2019 (në lekë)

ECURIA E REALIZIMIT BUXHETOR PËR VITIN 2019			
Struktura Buxhetore	Shpenzimet Progressive Fakt	Plani Vjetor sipas ndryshimeve te bera gjate vitit	Realizimi ne Perqindje
600 <i>Llogaria e pagave</i>	13,457,586	13,800,000	97 %
601 <i>Kontribute sig. shoq. shënd.</i>	2,217,676	2,700,000	82 %
602 <i>Shpenzime te tjera Korrente</i>	3,373,439	5,500,000	61 %
604/1 <i>Tranferta GRANTE</i>	99,749,919	101,000,000	98 %
231 <i>Investime të brendshme</i>	838,720	1,000,000	83 %
606 <i>Transferta Familjare dhe Individët</i>	23,369	30,000	77 %
Totali	119,703,080	124,030,000	96 %

Grafiku Nr. 6



Analiza e realizimit të treguesve buxhetorë për Vitin 2019

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zëri 600-601), është **realizuar** në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar me Vendim nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, ndryshuar me Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, të Ligjit Nr. 99, datë 03.012.2018 “Për Buxhetin e Vitit 2019” si dhe në kuadër të Udhëzimit Plotësues nr.1 datë 17.01.2019 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2019”, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, sipas Vendimit Nr. 16, datë 16.1.2019 “Për përcaktimin e numrit të me kontratë të përkohshme për Vitin 2019 për njësitë e qeverisjes qendrore” numri mesatar i punonjësve për AMShC-në është realizuar 16 punonjës të përhershëm si dhe dy punonjës me kontratë të përkohshme.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve si dhe i sigurimeve shoqërore, gjatë këtij viti, është realizuar respektivisht:

- **13,457,586 Lekë** (zëri 600) për paga, realizimi **97%**.
- **2,217,676 Lekë** (zëri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore shendetsore, realizimi **82%**.
- Shpenzimet e Personelit janë realizuar në vlerën **15,675,262 lekë në total dhe 95% me përqindje** që do të thotë që është një realizim shumë i mirë i fondit të pagave dhe sigurimeve për Vitin 2019.

Fondi për shpenzime të tjera korrente (zëri 602), për vitin 2019, është planifikuar fillimisht me Ligjin e Buxhetit të Vitit 2019 në vlerën **5,500,000 lekë**.

Ka pasur rritje në këtë zë buxheti nga viti i mëparshëm nisur edhe nga detyrat e rejtat që AMShC-ja ka përbushur si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) duke mbuluar aktivitetet e KKSHC-së si dhe për të siguruar facilitetet logjistike për organizimin e takimeve dhe mbledhjeve të KKSHC-së.

Ofrimi i asistencës ligjore në finalizimin e Udhërrëfyesit për Shoqërinë Civile, ku AMShC ndërmori një rol të rëndësishëm në hartimin dhe mirëpërcaktimin e planit të punës dhe më gjerë. Për këtë funksion, AMShC gjithashtu ndërmori një sërë masash me qëllim realizimin sa më të saktë të tij duke përthithur produktin final (miratimin e Udhërrëfyesit). Në kuadër të zbatimit të këtij Udhërrefyesi të rishikuar, janë specifikuar detyrat për çdo Institucion dhe aktorë të Shoqërisë Civile të përfshirë.

AMShC-ja së bashku me Kryeministrinë ka edhe detyrën e rëndësishme të monitorimit të zbatimit të Udhërrefyesit për një mjedis mundësues të Shoqërisë Civile si mekanizmi dhe plani kryesor i punës për lehtësuari dhe mundësimin e aktivitetit të OJF-ve në vend.

Roli aktiv i AMShC-së në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit është një tjetër arritje e Institucionit duke ndikuar sadopak në plotësimin e masave dhe indikatorëve sa i përket Qasjes Ndërgjegjësuese. Për këtë qëllim, AMShC ka tashmë programin e saj Institucional kundër Korrupsionit, një buxhet të dedikuar për projektet anti-korrupsion. Në zërin buxhetor të AMShC-së, disa shpenzime janë dedikuar edhe kësaj strategjie.

Edhe për këtë zë, për gjatë vitit 2019 është realizuar vlera prej **3,373,439 Lekë** ose **61 %** e planit vjetor të rishikuar për AMShC-në, disa shpenzime të planifikuara ose evente të KKSHC-së nuk u

realizuan, gjithashtu lëvizjet brenda territorit në muajt e fundit të Vitit 2019 u ndërprejnë me urdhër të Ministrisë së Financave.

Një arsye tjetër për këtë rezultat faktik të shpenzimeve të zërit shpenzime, mirëmbajtje llogaria 602 janë edhe procedurat e prokurimeve online, ku është synuar gjithmonë për çmimin më të ulët për blerjet në kuadër të logjistikës së përgjithshme për ecurinë normale të punës në Institucion.

Në realizimin e shpenzimeve operative, AMShC-ja është mbështetur në parimin e një shpërndarje sa më racionale të kërkesave për ecurinë optimale të veprimtarisë së Institucionit si dhe ka zbatuar “Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike” për blerje dhe shërbime të cilat kryesisht lidhen me:

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevoja të AMShC-së, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, lysterje dhe mirëmbajtje, pastrim etj.
- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitorë dhe të tretë etj.
- Kryerjen e monitorimeve në terren të projekteve që AMShC ka financuar gjatë vitit 2019.

Realizimi i plotë i fondit për Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes argumentohet me arsyet si me poshtë vijon:

Së pari, gjatë vitit 2019 janë realizuar pjesa më e madhe e praktikave të prokurimeve të parashikuara në Rregjistrin e Prokurimeve Publike dhe gjithashtu janë realizuar programet e punës përse i përket monitorimeve në terren të projekteve që AMShC-ja ka financuar dhe monitoruar gjatë vitit 2019.


Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (zëri 604), për vitin 2019 është planifikuar në vlerën **101,000,000 lekë**. Ky është dhe zëri më me peshë në strukturën e buxhetit të AMShC-së, duke qenë se dhe vete misioni i këtij institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projekt-propozimet e OJF përfituese. Edhe për këtë zë, aktualisht **604 Kapitulli 1** për periudhën respektive është realizuar vlera prej **97,960,000 lekë** ose **97% e planit vjetor**.

Ndërkohë disbursimet e zërit të Granteve kanë përfshirë disbursime nga Thirrja Nr. 8, Thirrja Nr. 9 dhe në gjysmën e dytë të Vitit fiskal 2019 janë disbursuar Projektet fituese të Thirrjes Nr. 10 organizuar nga AMShC-ja.

Ecuria e disbursimeve të granteve financiare

Në Tabelën më poshtë, evidentohet **ecuria e disbursimeve të granteve financiare** (Llogaria 604 - Disbursimi i Granteve) sipas muajve gjatë vitit 2019, si dhe në grafikun më poshtë qartësohet kjo ecuri disbursimi në formë grafiku ku shihet që disbursimet e granteve më së shumti janë përqendruar në muajin Korrik pas shpalljes së OJF-ve fituese të Thirrjes nr. 11 si dhe në Dhjetor, ku sipas përcaktimeve të kontratave lidhur mes OJF-ve dhe AMShC-së

Grafiku Nr. 7



Fondi për shpenzim investime (zëri 231), për Investime të Trupëzuara 1,000,000 lekë.

Gjatë tre mujorit të katërt të vitit 2019, janë finalizuar edhe praktikatat e prokurimit dhe ndjekjes përsa i përket fondit të investimeve. Në total për këtë zë janë disbursuar **838,720 lekë, që përbëjnë 83% të fondit të Investimeve**. Pjesa e parealizuar e fondit të Investimeve arsyetohet me ndjekjen e procedurave online të Prokurimeve publike dhe lidhjes së kontratave me çmimin më të ulët. Investimet këtë vit kanë shkuar për përmirësimin e rrjetit të IT-së në Institucion, për përmirësimin e gjendjes së ambienteve të brendshme të zyrave etj.

AMShC është një Institucion qendror buxhetor i krijuar me Ligjin Nr. 10093 Date 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe VKM Nr. 769 Date 15.07.2009 “Per Miratimin e Statutit të AMShC-se” (i ndryshuar), me Mision themelor **“Nxitjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shoqërisë Civile”** si dhe **“Krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile”**, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për realizimin e Misionit, AMShC-ja ofron **“asistencë financiare”** për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera si trajnime/workshops/konferenca/takime rajonale, që lehtësojnë përbushjen e misionit të saj.

Duke filluar nga **muaji Nëntor 2010 e deri në fund të vitit 2019** Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile udhëhequr nga Bordi Mbikqyrës i AMShC-së, ka organizuar **12 Thirrje për Projekt-Propozime** sipas prioriteteve dhe fushave të cilat janë objektiva të përhershëm të Institucionit, dhe janë kryer procedurat e duhura konform Ligjeve në fuqi në lidhje me njoftimin, shpalljen, vlerësimin, seleksionimin dhe kontraktimin e Organizatave Jofitimprurëse për financimin me Grante të projekteve që kanë rezultuar fituese.


Më tej puna konkrete e AMShC-së si Institucion, mbetet ndjekja e Projekteve deri në fazën finale të realizimit të tyre, Monitorimi dhe Vlerësimi i ecurisë së realizimit të Aktiviteteve konform projekt-propozimit dhe kontratës së lidhur mes palëve si dhe Monitorimi dhe Vlerësimi i ecurisë së realizimit financiar të Projekteve të financuara nga AMShC-ja dhe përputhshmëria me buxhetin e parashikuar si dhe me legjislacionin fiskal dhe tatimor të Republikës së Shqipërisë.

Sasia e granteve dhe Organizatave Jofitimpruese (OJF) të kontraktuara për t'u financuar për secilën Thirrje të organizuar nga AMShC paraqitet në tabelën si vijon:

Tabela Nr. 7

Thirrja	Numri i OJF-ve Përfituese	Vlere e Granteve financiare (në Lekë)
Thirrje Nr. 1	52	125,918,000
Thirrje Nr. 2	31	16,000,000
Thirrje Nr. 3	69	131,960,000
Thirrje Nr. 4	63	62,105,000
Thirrje Nr. 5	47	55,200,000
Thirrje Nr. 6	21	43,755,840
Thirrje Nr. 7	41	73,500,000
Thirrje Nr. 8	18	36,000,000
Thirrje Nr. 9	41	85,200,000
Thirrje Nr. 10	35	95,100,000
Thirrje Nr. 11	45	107,700,000
Thirrja Nr. 12	52	115,600,000
TOTAL	515	948,038,840

Grafiku Nr. 8



Puna kryesore e AMShC-së për Vitin 2019 është përqendruar në realizimin me sukses të Thirrjeve për Projekt-Propozime si dhe ndjekjes/Monitorimit/Vlerësimit të projekteve të zbatuara në kuadër të këtyre Thirrjeve.

Fushat prioritare të shpërndarjes së fondeve për Vitin 2019 për Thirrjen për Projekt-propozime paraqiten si më poshtë vijon:

- **THIRRJA NR. 11 (11 JANAR - 12 SHKURT 2018)**

Fushat prioritare:

- 1. Kujdesi ndaj mjedisit dhe ambientit, duke promovuar nisma ndërgjegjësuere dhe aksione të tjera në drejtimin e mirëmbajtjes ambientale dhe territoriale dhe prioritetet e tjera:**
2. Fuqizimi i kapaciteteve rinore në fushën e vullnetarizmit, trajnimeve, sipërmarrjes sociale, turizmit dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm si dhe protagonizmit në krijimin e organizatave të shoqërisë civile;
3. Mbështetje për shtresat në nevojë dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë (jetimët, personat me aftësi të kufizuar, minoritete, LGBTI, etj) nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të tyre dhe aksioneve të përfshirjes komunitare;
4. Fuqizimi i shtetit të së drejtës, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që kanë në fokus luftën ndaj korupsionit, qytetarinë aktive, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjet lokale dhe qëndrore si dhe advokacinë për nisma ligjore;
5. Turizmi dhe kultura, si një binom zhvillimi për territorin e Shqipërisë, nëpërmjet iniciativave që kanë si qëllim rritjen e përdorimit të resurseve turistike dhe kulturore, të ndërthurura me protagonizmin rinor dhe atë të shoqërisë civile

- **THIRRJA NR. 12 (28 SHKURT - 1 PRILL 2019)**

Fushat prioritare:

5. Rinia - Investim dhe garanci për të ardhmen evropiane të vendit

- Fuqizimi i kapaciteteve për sipërmarrje në fusha të ndryshme zhvillimit (promovimi i produkteve vendase, zhvillimi i turizmit rural dhe urban, historike, kulturore, etnografike, folklorike, etj.)
- Aktivizimi i grupeve studentore të ekselencës në programe të studimeve shkencore, inovative etj.
- Rinia në tregun e vlerave (art, kulturë, inovacion etj.), ura bashkëpunimi mes gjeneratave Rinia dhe Mosha e tretë (shkëmbim eksperiencash, diskutime miqësore, histori nga e kaluara etj.)
- Rinia në fokusin gjithëpërfshirës në garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm

- Tryeza sensibilizimi dhe diskutimi, nisma për zhvillimin e aktivizmit dhe vullnetarizmit, pjesëmarrjes, sipërmarrjes, partneritet, arsimit, aftësimet profesional etj.

6. Integrimi - Shoqëria civile si faktor, aktor dhe partner i rëndësishëm në proceset e integritit evropian dhe rajonal të vendit

- Sensibilizim, fuqizim kapacitetesh për një mjedis mundësues në proceset integruese
- Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj.
- Mirëqeverisja (Pushteti Qendror dhe Lokal), transparencë, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, përgjegjshmëria dhe integriteti, reforma në drejtësi, rritje kapacitetesh, inovacion, monitorim, partneritet etj.
- Fuqizim kapacitetesh në ideim, shkrim, zbatim, monitorim dhe raportim të projekteve për shoqatat rinore, rurale, të sapokrijuara; aplikimi i metodës LEADER etj.
- Edukim qytetar në funksion të proceseve integruese (familja, shkolla, komuniteti, biznesi, institucionet shtetërore etj.)

7. Zhvillimi Social, shërbimet sociale

- Partneritet me grupet në nevojë në fuqizim kapacitetesh etj.
- Mbështetje për grupet në nevojë (persona të dhunuar; grupe të traumatizuara; fëmijët e braktisur; të ngujuarit; etj.), parandalimi i konfliktit dhe dhunës; asistencë psikologjike; zgjidhje paqësore e konflikteve, mbrojtja nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme etj.
- Fuqizimi/Diversifikimi i shërbime sociale për grupet në nevojë në garantimin e të drejtave të njeriut, në të gjithë spektrin e jetës politike, ekonomike, kulturore, sociale etj.

8. Mjedis, Turizmi dhe Zhvillimi i qëndrueshëm

- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmbytjet, zjarret, tërmete etj.)
- Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe konkurrues i zhvillimit të qëndrueshëm
- Promovimi dhe ruajtja e vlerave historike, etnografike, turistike, artistike, kulturore, guidat turistike, koleksionistët, tolerancës fetare etj. si vlera historike e kombit shqiptar dhe detyrim ndaj brezave të ardhshëm

KAPITULLI V

Aktivitetet kryesore të AMShC-së për vitin 2019

Shoqata maqedonase "Ilinden" – Tiranë feston 10-vjetorin e krijimit

Tiranë, 6 shkurt 2019


Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në pritjen e organizuar me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Shoqatës maqedonase "Ilinden" – Tiranë, me ftesë të z. Nikolla Gjurgjaj, kryetar i Shoqatës.

Fjalën e hapjes e mbajti z. Tihomir Stojanovski, profesor në Fakultetin e Arteve Dramatike në Shkup, Republika e Maqedonisë; z. Nikolla Gjurgjaj, kryetar i shoqatës maqedonase "Ilinden" – Tiranë si edhe z. Danko Markovski, ambasador i Republikës së Maqedonisë në Tiranë.

Në vijim z. Gjurgjaj shpërndau çmime dhe çertifikata mirënjohjeje për personat me meritë të veçantë në jetën, historinë, kulturën dhe ruajtjen e traditës autentike maqedonase në Shqipëri.

Gjatë ceremonisë u prezantuan librat:

1. Dekada e shoqatës maqedonase "Ilinden" – Tiranë
2. Maqedonasit dhe shqiptarët nga Kongresi i Berlinit deri në kryengritjen Ilinden
3. Etnografia dhe antropologjia e maqedonasve "Nashinski" nga kufiri maqedono - shqiptar – nga Dr. Meri Stojanova



Takimi III i Komitetit Drejtues të Programit "Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri" – Faza e II, 2017-2020

Tiranë, 14 shkurt 2019

Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile mori pjesë në takimin e III të Komitetit Drejtues të Programit "Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri", faza e 2-të, Periudha e Zbatimit 2017-2020, i cili u mbajt pranë ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ky projekt financohet nga Sida (Swedish International Development Cooperation Agency) dhe implementohet nga FCG Swedish Development AB. Hapjen e takimit dhe prezantimin e agjendës e mbajti z. Ansi Shundi, Drejtuesi i Ekipit të

Menaxhimit të Programit, ndërsa në vijim z. Ardi Veliu, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, njëherazi edhe Kryetar i Komitetit Drejtues të Programit shprehu vlerësimet e Policisë së Shtetit për rezultatet e programit. Në takim u prezantua plani i aktiviteteve të programit dhe i progresit të deritanishëm për periudhën 1 korrik 2018 – 31 dhjetor 2018. Në përfundim pati diskutime të pjesëmarrësve mbi aktivitetet dhe pritshmëritë e tyre për programin.



Takime konsultimi me përfaqës të Pushtetit Vendor dhe të Organizatave të Shoqërisë Civile ër përcaktimin e prioriteteve të Thirrjes Nr. 12 për projekt-propozime

Janar – Shkurt 2019

Me synim konsultimin publik në lidhje me prioritetet e Thirrjes së radhës Nr. 12 si dhe në kuadër të një bashkëpunimi sa më të frytshëm e të suksesshëm midis Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Pushtetit vendor, nën moton: *“Fuqizohemi së bashku”* u organizuan takime konsultative në qytetet dhe datat e mëposhtme:



KONSULTIM PUBLIK
me përfaqësues të Pushtetit Vendor dhe të Organizatave të Shoqërisë Civile
mbi përcaktimin e prioriteteve të Thirrjes Nr. 12 për projekt-propozime

**KORÇË • GJIROKASTËR • PESHKOPI
SHKODËR • VLORË • KUKËS • TIRANË**

ONLINE: www.amshc.gov.al

1. **KORÇË** 22 – 23 janar 2019
2. **GJIROKASTËR** 25 janar 2019
3. **PESHKOPI** 29 – 30 janar 2019
4. **SHKODËR** 31 janar 2019
5. **VLORË** 5 – 6 shkurt 2019
6. **KUKËS** 7 – 8 shkurt 2019
7. **TIRANË** 14 shkurt 2019



Korçë, 22 janar 2019
Takim me Organizata të Shoqërisë Civile në Korçë



Korçë, 23 janar 2019
Takim me përfaqësues nga Sektori i Projekteve të Bashkisë Korçë



Gjirokastrë, 25 janar 2019
Takim me znj. Albana Allushaj – Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Gjirokastrë



Gjirokastrë, 25 janar 2019
Takim me Organizata të Shoqërisë Civile në Gjirokastrë


Në këto takime përfaqësuesit e AMShC-së parashtuan çështjet kryesore:

- Sfidat dhe prioritetet e sektorit të Shoqërisë Civile për secilin qark dhe më konkretisht, sa nga OJF-të e regjistruara janë aktive në qytete dhe zonat përreth, të cilat kontribuojnë për zgjidhjen e këtyre sfidave
- Marrja e një feedback-u për problematikat e ndryshme dhe sugjerimet për mbështetje financiare, për zgjidhjen e tyre nëpërmjet kontributit të Shoqërisë Civile
- Nxjerrja e fushave prioritare të cilat duhet të përfshihen në thirrjen e radhës, të propozuara nga pjesëmarrësit dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile



Shkodër, 31 Janar 2019

Takim me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile së bashku me znj. Deana Alibali dhe znj. Stela Mardusha nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit në Bashkinë Shkodër



Vlorë, 5 shkurt 2019

Takim me z. Jeton Puka – Këshilltar ekonomik i Kryetarit të Bashkisë Vlorë



Vlorë, 6 shkurt 2019

Takim me Organizata të Shoqërisë Civile në Vlorë

Në takimet e organizuara si dhe nga shqyrtimi i të gjitha materialeve të marra në rrugë elektronike dhe në formë të shkruar (hard copy), ku përfaqësuesit e OJF-ve, pushtetit vendor dhe grupeve të tjera të interesit listuan të gjitha sugjerimet e tyre, janë përmbledhur si më poshtë:

1. *Mbështetja e projekteve për mbrojtjen e mjedisit me fokus pyjet dhe vendburimet termale; Fokusim dhe adresim i dëmeve të shkaktuara gjatë tranzicionit dhe në vijim në hapësirat detare dhe bregdetare shqiptare*
2. *Zhvillimi i turizmit dhe kryesisht atij familjar duke pasur parasysh prodhimet tradicionale të zones*
3. *Arti dhe trashëgimia kulturore; aktivizimi i brezave të rinj për të ruajtur trashëgiminë dhe identitetin tonë kulturor*
4. *Zbatimi i metodës LEADER nëpërmjet krijimit dhe fuqizimit të Forumeve rurale, për të nxitur lobim, advokaci dhe përfaqësim të komuniteteve në zonat rurale, kryesisht malore dhe të defavorizuara*
5. *Mbështetje për medien investigative locale*
6. *Korrupsioni dhe lufta kundër tij*
7. *Mirëqeverisja vendore*
8. *Monitorimi i Reformës në Drejtësi dhe procesit të vetingut*
9. *Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve*
10. *Bashkëveprimi i rinisë në fushatat sensibilizuese për promovimin e talenteve të reja në art, kulturë dhe sculpture*
11. *Mbështetje dhe aksesueshmëria për personat me aftësi ndryshe, përfshirja sociale e personave me aftësi intelektuale*
12. *Sensibilizim, mobilizim dhe aktivizim i të rinjve në proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia*
13. *Sensibilizimi i të rinjve në përdorimin e masave mbrojtëse nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme*
14. *Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, kryesisht në zonat rurale*
15. *Mbështetje për arsimimin profesional, fuqizimin dhe punësimin e grave e të rinjve*
16. *Identifikim, adresim dhe zhvillim të zonave rajonale natyrore me potenciale turistike të riskuara nga zhvillimet ekonomike të pakontrolluara*
17. *Promovimi i harmonisë dhe bashkëjetesës fetare*
18. *Përmirësimi i shërbimeve sociale*
19. *Mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë*
20. *Rritja e kapaciteteve të OJF-ve për hartimin e projekteve konkrete, sidomos atyre lokale*



Kukës, 7 shkurt 2019
Takim me z. Dilaman Nela - Nënkyetar i Bashkisë Kukës



Kukës, 8 shkurt 2019
Takim me Organizata të Shoqërisë Civile në Kukës



Tiranë, 14 shkurt 2019
Takimit konsultativ përmbyllës me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile në Tiranë

Nga bashkëbisedimet me përfaqësuesit e pushtetit vendor u vërejt gatishmëri për bashkëpunim institucional si dhe ofrimin e fasiliteve dhe mbështetjes për implementimin e projekteve të OJF-ve.



Përfaqësues të KKShC-së takim mbi samitin e II të Diasporës

Tiranë, 20 shkurt 2019



Përfaqësues të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) ndanë opinione lidhur me Strategjinë Kombëtare për Diasporën dhe Planin e Veprimit të Qeverisë shqiptare, qëllimi i së cilës është të përfshijë dhe fuqizojë pjesëmarrjen e diasporës dhe migrantëve si faktor përmbajtësor i zhvillimit të Shqipërisë.

Samiti i II i Diasporës shqiptare do të mbahet në kuadër të 575-vjetorit të Kuvendit të Lezhës dhe KKShC fton të gjithë të interesuarit të bëhen pjesë aktive e kësaj ngjarje duke u regjistruar në faqen: <http://samiti.diaspora.gov.al>

AMShC shpall Thirrjen Nr. 12 për shprehje interesi

28 shkurt – 1 prill 2019

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) shpall Thirrjen Nr. 12, ku ftohen OJF-të e interesuara të sjellin projekt-propozime që kanë si objekt dhe mbulojnë fushat prioritare:



www.amshc.gov.al



The CALL for proposal

February 28th - April 1st 2019

1. Rinia – Investim dhe garanci për të ardhmen evropiane të vendit

- Fuqizimi i kapaciteteve për sipërmarrje në fusha të ndryshme zhvillimit (promovimi i produkteve vendase, zhvillimi i turizmit rural dhe urban, historike, kulturore, etnografike, folklorike, etj.)
- Aktivizimi i grupeve studentore të ekselencës në programe të studimeve shkencore, inovative etj.
- Rinia në tregun e vlerave (art, kulturë, inovacion etj.), ura bashkëpunimi mes gjeneratave Rinia dhe Mosha e tretë (shkëmbim eksperiencash, diskutime miqësore, histori nga e kaluara etj.)
- Rinia në fokusin gjithpërfshirës në garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm
- Tryeza sensibilizimi dhe diskutimi, nisma për zhvillimin e aktivizmit dhe vullnetarizmit, pjesëmarrjes, sipërmarrjes, partneritet, arsimit, aftësimin profesional etj.

2. Integrimi – Shoqëria civile si faktor, aktor dhe partner i rëndësishëm në proceset e integrimit evropian dhe rajonal të vendit

- Sensibilizim, fuqizim kapacitetesh për një mjedis mundësues në proceset integruese
- Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj.
- Mirëqeverisja (Pushteti Qendror dhe Lokal), transparencë, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, përgjegjshmëria dhe integriteti, reforma në drejtësi, rritje kapacitetesh, inovacion, monitorim, partneritet etj.
- Fuqizim kapacitetesh në ideim, shkrim, zbatim, monitorim dhe raportim të projekteve për shoqatat rinore, rurale, të sapokrijuara; aplikimi i metodës LEADER etj.
- Edukim qytetar në funksion të proceseve integruese (familja, shkolla, komuniteti, biznesi, institucionet shtetërore etj.)

3. Zhvillimi Social, shërbimet sociale

- Partneritet me grupet në nevojë në fuqizim kapacitetesh etj.
- Mbështetje për grupet në nevojë (persona të dhunuar; grupe të traumatizuara; fëmijët e braktisur; të ngujuarit; etj.), parandalimi i konfliktit dhe dhunës; asistencë psikologjike; zgjidhje paqësore e konflikteve, mbrojtja nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme etj.
- Fuqizimi/Diversifikimi i shërbimeve sociale për grupet në nevojë në garantimin e të drejtave të njeriut, në të gjithë spektrin e jetës politike, ekonomike, kulturore, sociale etj.

4. Mjedi, Turizmi dhe Zhvillimi i qëndrueshëm

- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmytjet, zjarret, tërmete etj.)
- Aktivizimi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe konkurrues i zhvillimit të qëndrueshëm
- Promovimi dhe ruajtja e vlerave historike, etnografike, turistike, artistike, kulturore, guidat turistike, koleksionistët, tolerancës fetare etj. si vlera historike e kombit shqiptar dhe detyrim ndaj brezave të ardhshëm

Takime informuese dhe konsultimi mbi procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Shkurt – Mars 2019

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) përgjatë muajve Shkurt – Mars 2019 zhvilloi disa takime informuese dhe konsultimi mbi procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile të KKShC-së me organizata të shoqërisë civile.

Takimet informuese u zhvilluan sipas kalendarit:

- 1. Berat, 26 shkurt 2019*
- 2. Vlorë, 28 shkurt 2019*
- 3. Gjirokastrë, 5 mars 2019*
- 4. Sarandë, 6 mars 2019*
- 5. Kukës, 8 mars 2019*
- 6. Korçë, 12 mars 2019*
- 7. Shkodër, 13 mars 2019*



Gjatë takimeve të përfaqësuesve të AMShC-së dhe KKShC-së me përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, u prezantuan dhe u diskutuan kriteret për kandidatët, dokumentacionet mbështetëse dhe fazat e procesit për përzgjedhjen e kandidaturave për anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Takim i përbashkët pune i Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri dhe Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile mbi OGP

Tiranë, 15 mars 2019



Në kuadër të angazhimit të marrë nga Qeveria Shqiptare për të qenë pjesë e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (Open Government Partnership – OGP) dhe vizitës së përfaqësuesve të lartë të OGP-së z. Joe Powell, Zëvendësdrejtori Ekzekutiv dhe znj. Sandra Pernar, Koordinatore e Lartë Rajonale për Evropë, u zhvillua një takim i përbashkët pune i Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri dhe Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC).

Ky event me temë “Open Government Partnership Visit to Albania” u mbaj pranë ambjenteve të Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD), në Kryeministri.

Të pranishëm ishin përfaqësuesit e lartë të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (OGP), Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) si dhe Organizata të Shoqërisë Civile. Takimi i përbashkët i punës u drejtua nga znj. Ardiana Jaku – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në këtë takim të përbashkët pune, u prezantua Plani i Katërt Kombëtar i Veprimit për Qeverisjen e Hapur për Shqipërinë 2018 – 2020.



Tryezë me temë mbi përmirësimin e politikave të qeverisjes lokale

Tiranë, 20 mars 2019




Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) marrin pjesë në aktivitetin me temë "Përmirësimi i politikave të qeverisjes lokale nëpërmjet pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve", të organizuar nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane, projekt mbështetur nga USAID. Të pranishëm ishin përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, të shoqërisë civile si dhe Drejtori i ADISA, z. Lorin Ymeri. Takimi kishte në fokus paraqitjen e rezultateve të studimit të zhvilluar në qytetin e Tiranës, njëres prej pesë bashkive të përzgjedhura për implementimin e këtij projekti.

AMShC solidarizohet me nismën "Dhurimi i gjakut – një akt human i cili shpëton jetë"

Tiranë, 4 prill 2019

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) solidarizohet me nismën "Dhurimi i gjakut – një akt human i cili shpëton jetë", ku përfaqësues të saj dhuruan gjak vullnetarisht. Kjo nismë është ndërmarrë nga bashkëpunimi i Qendrës së Transfuzionit të Gjakut në Tiranë dhe Fondacionit Fundjavë Ndryshe dhe gjaku i dhuruar do të jetë ndihmë e shtuar për të sëmurët talasemikë.



EU Policy HUB & Friedrich Ebert Stiftung Tirana / Tryezë e Rrumbullakët: "Kontributi i Shoqërisë Civile në Procesin e Integritit në BE"

Tiranë, 18 prill 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në tryezën e rrumbullakët "Kontributi i Shoqërisë Civile në Procesin e Integritit në BE", të organizuar nga EU Policy HUB & Friedrich Ebert Stiftung Tirana, e cila u mbajt në ambjentet e Hotel Rogner.

Ky aktivitet synon që një grup përfaqësuesish të shoqërisë civile të fushës së Integritit në BE, ekspertëve si dhe akademikë të fushës, të diskutojnë sfidat, pengesat dhe zgjidhjet që lidhen me një rol më të fortë

dhe më të angazhuar të Organizatave të Shoqërisë Civile në proceset e bërjes së politikave dhe reformat përkatëse të nevojshme për të arritur anëtarësimin në BE.

Gjatë këtij takimi u prezantuan edhe gjetjet e studimit të Tom Moddenborg nga Universiteti i Leipzig-ut, i cili ofron një analizë të thelluar dhe një qasje të krahasueshme ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë lidhur me rolin e rëndësishëm që organizatat e shoqërisë civile kanë në procesin e konsultimeve të politikave të reja si dhe nga an tjetër një mbikëqyrje e masave dhe reformave qeveritare.

Takim konsultues në kuadër të hartimit të raportit mbi zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit 1995 (Pekin +25)

Tiranë, 19 prill 2019

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në një takim konsultues në kuadër të hartimit të raportit mbi zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit 1995 (Pekin +25), të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si autoriteti kryesor përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, në bashkëpërgjegjësi dhe konsultim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), ku të pranishëm ishin edhe nga grupet e interesit dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.



Në hartimin e këtij Raporti, MSHMS dhe MEPJ u mbështeten edhe në informacionet e kërkuara paraprakisht nga një pjesë e institucioneve të pavarura dhe organizatave të shoqërisë civile.

2020-ta përkon me një vit të rëndësishëm analize mbi hapat e hedhur në drejtim të barazisë gjinore dhe fuqizimit të të gjitha grave dhe vajzave, si dhe mbi zbatimin e angazhimeve të tjera globale, siç janë ato të Rezolutës 1325 (2000) të Këshillit të Sigurisë dhe rezolutat e mëvonshme për gratë, paqen dhe sigurinë; Axhendës së Veprimit të Adis Abebës në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare mbi Financimin për Zhvillim (2015); Marrëveshjes së Parisit mbi ndryshimet klimatike (2015), etj.

Raportimi do të përqendrohet në arritjet dhe sfidat në të 12 fushat e përcaktuara në Platformë, konkretisht:

1. Gratë dhe varfëria;
2. Arsimi dhe trajnimi i grave;
3. Gratë dhe shëndeti;
4. Dhuna ndaj grave;
5. Gratë dhe konfliktet e armatosura;
6. Gratë dhe ekonomia;
7. Gratë në politikë dhe vendimmarrje;
8. Mekanizmat institucionalë për përparimin e grave;
9. Të drejtat njerëzore të grave;
10. Gratë dhe media;
11. Gratë dhe mjedisi;
12. Fëmija vajzë.

Kjo analizë po pasqyrohet sipas gjashtë grupeve tematike, duke marrë në konsideratë dhe pyetjet orietuese për secilën, siç sugjerohet në udhëzimet përkatëse të UN Women dhe UNECE për këtë qëllim, respektivisht:

1. Zhvillimi gjithëpërfshirës, prosperiteti i përbashkët dhe puna e denjë
2. Çrrënjësja e varfërisë, mbrojtja sociale dhe shërbimet e kujdesit shoqëror
3. Liria nga dhuna, stigma dhe stereotipet
4. Pjesëmarrja, llogaridhënia dhe institucione të përgjigjshme gjinore
5. Shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse
6. Ruajtja, mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit



AMShC shpall thirrjen për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

22 prill 2019 – 20 maj 2019

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), shpall thirrjen për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në KKShC, për 4 (katër) vendet vakante të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 1-vjeçare, përkatësisht:

- **1 (një) anëtar** për fushën e veprimit B:
“Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor”
- **3 (tre) anëtarë** për fushën e veprimit C:
“Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”

Faza e procesit të Propozimit të Kandidatëve anëtarë të KKShC-së është e hapur **nga data 22 prill 2019 deri më 20 maj 2019, ora 16:30**, kohë në të cilën paraqiten kandidaturat dhe dokumentacionet mbështetëse si nga ana e organizatave propozuese të kandidatëve, ashtu edhe nga ana e të kandiduarve.

Për më shumë informacione vizitoni faqen www.amshc.gov.al/kkshc.

IDM Albania / Forumi i Politikave "Evropianizimi përtej procesit"

Tiranë, 23 prill 2019



Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në Forumin e Politikave: "Evropianizimi përtej procesit", i cili u organizua nga "Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim" dhe ku morën pjesë ekspertë shqiptarë si dhe përfaqësues të lartë nga think tank-e të njohura të BE-së: Qendra për Studime Politike Evropiane – CEPS Bruksel, Nisma për Stabilitetin Evropian – ESI Berlin, dhe Qendra e Politikave Evropiane – EPC Bruksel.

Qëllimi i Forumit të Politikave "Evropianizimi përtej procesit" është fillimi i një dimensionit të ri të shkëmbimit të përvojave midis think tank-eve nëpërmjet një sërë debatesh të cilat sjellin njohuritë

dhe këndvështrimet e organizatave studimore të njohura të BE-së.

Kjo nismë pritet të inkurajojë një proces mësimi për aktorët e interesuar në Shqipëri lidhur me një gamë të larmishme temash aktuale për BE-në, të tilla si; reformimi i BE-së, e ardhmja e Eurozonës, sundimi i ligjit dhe dobësimi i demokracisë, BREXIT, emigracioni, zgjedhjet evropiane, tregtia, roli i BE-së në botë dhe tema të tjera të lidhura me BE-në.

Në përfundim, procesi pritet të ofrojë një kuptueshmëri më të mirë të këtyre çështjeve, si dhe për mënyrën se si ato do të ndikojnë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe procesin e zgjerimit në vitet në vijim.

Partners Albania prezanton gjetjet dhe rekomandimet paraprake të "Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Shoqërinë Civile 2018 – Raporti për Shqipërinë"

Tiranë, 25 prill 2019

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në takim mbi prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve paraprake të "Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Shoqërinë Civile 2018 – Raporti për Shqipërinë", i cili u organizua nga Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile.



Takimi shërbeu si një forum diskutimi i fokusuar në një analizë të ndryshimeve të ndodhura gjatë periudhës janar 2018 – shkurt 2019 mbi kuadrin ligjor dhe praktik që afekton sektorin, me prezencën e zj. Alketa Knuti - zv. Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve donatore në vend.

Disa nga çështjet kryesore në të cilat u fokusua diskutimi ishin:

- *Rishikimi i Ligjit Nr. 8788, datë 7/5/2001, “Për Organizatat Jo-fitimprurëse”, ku të shprehet qartë dallimi midis veprimtarisë ekonomike dhe aktivitetit jofitimprurës të OJF-së.*
- *Rishikimi i nenit 45 të Ligjit Nr. 97/2018, datë 03.12.2018 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar mbi “Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve”.*
- *Regjistri elektronik i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për OJF-të, nevoja për saktësime dhe unifikim të të dhënave për sektorin.*
- *Çregjistrimi nga TVSH për OJF-të që nuk deklarojnë për 12 periudha të njëpasnjëshme TVSH të pagueshme.*
- *Ligji 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe ndryshimet që parashikon lidhur me raportimin e OJF-ve dhe publikimin e pasqyrave financiare.*

Në takim u prezantua studimi i fundit i realizuar nga Partnerët Shqipëri mbi një nga metodat alternative të financimit në ditët e sotme siç është Crowdfunding. Crowdfunding është një nga metodat risi të ngritjes së fondeve, e cila po përdoret gjerësisht nga sektori dhe sipërmarrjet sociale në rajon dhe Evropë, por është pak e eksploruar në Shqipëri. Nëpërmjet këtij studimi synohet informimi dhe nxitja e sektorit rreth përdorimit të kësaj metode për të gjeneruar fonde.



Raporti i “Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Shoqërinë Civile – Raporti për Shqipërinë” dhe materiali hulumtues “Platformat Crowdfunding: Një Burim Alternativ Financimi” do të publikohen brenda muajit Maj 2019.

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Qendra CVE) organizoi Konferencën e Parë Kombëtare “Aktorët e Vijës së Parë në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm”

Tiranë, 30 prill 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në Konferencën e Parë Kombëtare “Aktorët e Vijës së Parë në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm”, të organizuar nga Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Qendra CVE), e cila u mbajt në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

Në këtë konferencë kombëtare, u bënë së bashku punonjësit e vijës së parë - mësues, punonjës social, oficerët e policimit në komunitet – si dhe përfaqësues të ministrive të linjës dhe të ftuar nga shoqëria civile, komunitetet fetare, media, dhe partnerë rajonalë e ndërkombëtarë. Qëllimi kryesor i konferencës është prezantimi i rasteve konkrete dhe ndërhyrjeve në fushën e parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm të zbatuara nga aktorët e vijës së parë në të gjithë vendin.

Rastet e prezantuara gjatë konferencës: Arsimi; Mbrojtja Sociale; Policimi në Komunitet; Sistemi i Burgjeve; Qeverisja Vendore – nxitën diskutimin mbi rezultatet e arritura dhe krijimin e praktikave të mira për zbatimin e mëtejshëm të ndërhyrjeve në këtë fushë.

Instituti për Studime Publike & Ligjore (IPLS) prezanton dokumentin metodologjik “Monitorimi i Integritetit Gjyqësor”

Tiranë, 24 maj 2019



Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Andi Kananaj mori pjesë në takimin prezantues të dokumentit metodologjik “Monitorimi i Integritetit Gjyqësor”, i cili u organizua nga Instituti për Studime Publike & Ligjore (IPLS).

Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, që financohet nga Bashkimi Evropian në partneritet me “Save the Children” dhe “Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara”.



Në këtë aktivitet ishin të pranishëm Ministrja e Drejtësisë dhe Kryetarët e Qeverisjes së Gjyqësorit dhe Prokurorisë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari dhe Anëtarë të KED. IPLS ka draftuar Dokumentin metodologjik “Monitorimi i Integritetit Gjyqësor” dhe nëpërmjet këtij aktiviteti synon të prezantojë fushat kryesore të performancës së aktiviteteve gjyqësore, me faktorët, që duhen konsideruar për monitorimin e integritetit gjyqësor.

Ky dokument synon të kontribuojë në forcimin dhe zhvillimin e integritetit gjyqësor sipas një metodologjie bashkëkohore, të elaboruar dhe pranuar gjerësisht nga standardet ndërkombëtare të promovimit të integritetit gjyqësor.

Me qëllimin për të ndihmuar aktorët e shoqërisë civile si watchdog të integritetit gjyqësor, Metodologjia e Integritetit Gjyqësor synon t'u shërbejë atyre në aktivitete monitoruese të ardhshme, por edhe gjykatave dhe gjyqtarëve në përpjekjet për rritjen e integritetit gjyqësor, gjatë punës së tyre, e për rrjedhojë dhe në rritjen e besimit të publikut tek drejtësia.

Konsultim publik mbi IPA Maqedoni e Veriut - Shqipëri 2014 – 2020

Korçë, 7 qershor 2019

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në një konsultim publik në kuadër të "Programit IPA Maqedoni e Veriut - Shqipëri 2014 - 2020", i cili u mbajt në qytetin e Korçës.



Open Day - Qendra e Shërbimeve PRO PAK

Tiranë, 8 korrik 2019

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në ceremoninë e hapjes të Qendrës së Shërbimeve PRO PAK, të organizuar nga Fondacioni "Down Syndrome Albania" (DSA).



100 fëmijë me aftësi ndryshe dhe familjet e tyre në Shqipëri do të përfitojnë nga shërbimet në qendrën e sapo hapur të PRO PAK të menaxhuar nga Fondacioni "Down Syndrome Albania".

Të gjithë njerëzit me aftësi ndryshe kanë të drejtë të kenë qasje në të gjitha shërbimet publike, të kontribuojnë në komunitet dhe jetojnë një jetë me vlera.

Shërbimet kryesore të kësaj qendre:

1. Vlerësime nga ekipi multidisiplinar
2. Terapi fizike, psikomotricitet dhe hidroterapi
3. Terapi gjuhe dhe të foluri (logopedi)
4. Terapi zhvillimi dhe okupacionale
5. Terapi "Analiza e Aplikuar e Sjelljes" (ABA)
6. Terapi me metodën Floortime
7. Terapi Arti dhe Muzikoterapi
8. Terapi në grup
9. Shërbimi i ndërhyrjes së hershme terapeutike në mjedisin natyror të familjes
10. Shërbimi i mbështetjes në kopshte/ shkolla
11. Kursi i gjuhës dhe i matematikës
12. Kursi i kërcimit
13. Kursi i autonomisë personale për fëmijët 3- 13 vjeç
14. Kursi i autonomisë sociale për adoleshentë dhe të rritur
15. Këshillim psikologjik individual me prindërit
16. Terapi në grup me prindërit
17. Asistencë ligjore



Hospices of Hope lançon zyrtarisht projektet e saj në Shqipëri

Tiranë, 9 korrik 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në një Garden Reception me rastin e lançimit zyrtar të projektit në Shqipëri, të Hospices of Hope, i cili u mbajt në Grand Hotel & Spa Tirana.

Në këtë aktivitet ishin të ftuar Ambasadori Britanik në Shqipëri; diplomatë nga misionet e ndryshme ndërkombëtare si dhe përfaqësues biznesi vendor dhe ndërkombëtarë; përfaqësues të partnerëve të vendit Ryder Albania dhe ABC Center. Hospices of Hope është një organizatë bamirësie ndërkombëtare e themeluar në Mbretërinë e Bashkuar që i dedikoi pothuajse tre dekadat e fundit zhvillimit të shërbimeve të kujdesit paliativ në Evropën Jug-Lindore. Kujdesi paliativ është një qasje që përmirëson cilësinë e jetës së pacientëve dhe familjeve të tyre që përballen me problemin që shoqërohet me sëmundje të rrezikshme për jetën, përmes parandalimit dhe lehtësimit të vuajtjeve me anë të identifikimit të hershëm dhe vlerësimit të saktë dhe trajtimit të dhimbjes dhe problemeve të tjera, fizike, psiko-sociale dhe shpirtërore.



Misioni i Hospices of Hope në Shqipëri është të kontribuojë në zhvillimin e kujdesit paliativ brenda vendit dhe të rrisë hyrjen në këtë lloj shërbimesh për ata në nevojë. Për të përmbushur misionin e tij Hospices of Hope ka krijuar partneritete me organizatat vendore dhe po zbaton në mënyrë aktive katër projekte: Dy ekipe multidisiplinare të lëvizshme në Tiranë dhe Durrës me Ryder Albania; Një Qendër e Kujdesit Ditor Paliativ, e cila u zhvillua me Qendrën Shëndetësore ABC në Tiranë dhe një ekip të lëvizshëm për kujdes paliativ të integruar në Spitalin Rajonal të Kukësit.



Projekti mbulon shpenzimet e kujdesit, pagat, kostot administrative përfshirë transportin, trajnimet e kujdesit paliativ si dhe zhvillimin e një aplikacioni online për ofruesit e shërbimeve. Të gjitha shërbimet e ofruara në Rrjetin e Hospices of Hope janë falas për përfutuesit.

Projektet e Hospices of Hope Albania janë zbatuar me mbështetjen financiare të Fondacionit Medicor dhe Fondacionit Bristol-Myers Squibb.

AMShC shpall listën emërore përfundimtare të kandidaturave të kualifikuara për t'u votuar për anëtarë nga shoqëria civile në KKShC

Tiranë, 23 korrik 2019

Në kuadër të zgjedhjeve për katër vendet vakante të anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 1-vjeçare, AMShC në rolin e Sekretariatit Teknik të KKShC-së, shpall 14 (katërmbëdhjetë) kandidaturat e kualifikuara për t'u votuar, përkatësisht:

- **4 (katër) kandidatura** për fushën e veprimit B.
"Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor"
- **10 (dhjetë) kandidatura** për fushën e veprimit C.
"Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës"


VOTIM ONLINE për zgjedhjen e anëtarëve të KKSHC-së

24 – 31 korrik 2019

Në përfundim të procesit të hapur të votimit online, i aksesueshëm në adresën www.amshc.gov.al/kkshc, i cili zgjati për 8 ditë, rezultoi se votuan 425 votues.

AMSHC zhvillon takime prezantuese të masave kundër korrupsionit

Korrik – Gusht 2019



Në kuadër të zbatimit të strategjisë kundër Korrupsionit, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) organizoi takime prezantuese të masave anti-korrupsion në disa qytete të vendit me përfaqësues të shoqërisë civile. Këto masa organizohen në funksion të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, me qëllim ofrimin pranë aktorëve të shoqërisë civile obligimet e Institucionit të AMShC-së në zbatimin e kësaj strategjie. Përfaqësuesit e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) gjatë

takimeve informuese bënë prezantimin e masave dhe të planit të veprimit anti-korrupsion në tërësi të zgjatur deri në vitin 2023 si dhe diskutuan dhe shkëmbyen mendime me pjesëmarrësit në formë bashkëbisedimi për ofrimin e sugjerimeve për realizimin sa më të suksesshëm të masave.

Takimet u zhvilluan në qytetet:

- **Vlorë** 18 korrik 2019
- **Kukës** 25 korrik 2019
- **Sarandë** 1 – 2 gusht 2019
- **Korçë** 8 gusht 2019
- **Berat** 15 gusht 2018

Shpallen emrat e katër anëtarëve të rinj nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 26 gusht 2019

Pas përfundimit të fazës së numërimit dhe rikonfirmimit të votës online, në kuadër të zgjedhjeve për katër vendet vakante të anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 1-vjeçare, Komisioni Teknik i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) pranë KKShC-së shpalli emrat e katër anëtarëve të rinj të zgjedhur nga procesi i votimit:

- **Për fushën e veprimit B.**

"Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor"

1. **Shpëtim MYRTO**

Shoqata e Përdorimit të Pyjeve dhe Kullotave Komunare "DROJA-1", fshatrat Brret, Picrrage, Gjyraj-Krujë

- **Për fushën e veprimit C.**

"Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës"

1. **Atrida FERKEDI**

Gruaja në Integrim (GI)

2. **Fabiola LAÇO – EGRO**

Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"

3. **Indrit SEFERI**

Shoqata "MAYA" (Shoqata Rinore Mjekësore Shqiptare)

Gjithashtu, Komisioni Teknik i AMShC-së pranë KKShC-së bëri shpalljen dhe publikimin online në faqen zyrtare, rrjetet sociale dhe e-mail të "Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve Përfundimtare të Votimit" dhe "Listat emërore të kandidatëve të votuar me rezultatet përfundimtare të votimit".

Për më shumë informacion, vizitoni linkun: www.amshc.gov.al/kkshc

Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 23 shtator 2019

Zhvillohet pranë zyrave të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në orën 11:10 një takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC).



Pikat e agjendës së takimit:

- *Prezantimi i katër anëtarëve të rinj të zgjedhur;*
- *Monitorimi i zbatimit të "Udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023" të rishikuar të miratuar;*
- *Diskutim mbi organizimin e Konferencës së Parë Kombëtare të Shoqërisë Civile, ku të ballafaqohen përfaqësues të shoqërisë civile me përfaqësues të Qeverisë dhe komunitetit të donatorëve në lidhje me sfidat e këtij sektori;*
- *Diskutim mbi agjendën dhe organizimin e mbledhjes së Këshillit si dhe propozimi i caktimit të një date.*

Aktiviteti “Fuqizimi i llogaridhënies, transparencës dhe qendrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile – Kodi i Standardeve për OShC-të”

Tiranë, 26 shtator 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në aktivitetin “People2People” me temë “Fuqizimi i llogaridhënies, transparencës dhe qendrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile – Kodi i Standardeve për OShC-të”, të organizuar nga “Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërine Civile në Shqipëri (NRC)” dhe “Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim”.

Merrnin pjesë rreth 55 përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, agjenci ndërkombëtare dhe donator në Shqipëri, të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri dhe qëndrueshmërinë e tij.

Fokusi i aktivitetit ishte mundësia e krijimit të një mekanizmi vetë-rregullues dhe rritja e standardit të funksionimit të OShC-ve dhe transparenca e tyre.

Konferenca e dytë e Ballkanit Perëndimor - ReLOaD

Tiranë, 8 – 9 tetor 2019

Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në Konferencën e dytë të Programit “ReLOaD” të Ballkanit Perëndimor “Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies drejt përmirësimit të demokracisë lokale në Ballkanin Perëndimor”, e cila u zhvillua në Tiranë gjatë datave 8 dhe 9 tetor 2019. Në konferencë u prezantuan përvojat e bashkëpunimit midis autoriteteve lokale dhe shoqërisë civile në lidhje me transparencën e procedurave dhe qartësinë për financimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në të gjithë Ballkanin Perëndimor.



Fokus kryesor iu dha dallimeve dhe ngjashmërive legislative në të gjithë rajonin si dhe praktikatat ekzistuese dhe përvojat e Bashkimit Evropian.

Eventi u nda në tri seanca plenare:

1. *Financimi transparent i OShC-ve dhe përfitimet e tij në një komunitet lokal - perspektivat e qeverive lokale*
2. *Financimi transparent i OShC-ve dhe përfitimet e tij në një komunitet lokal - perspektivat nga OShC-të si përfitues të grantit*
3. *Si të përmirësojmë pjesëmarrjen qytetare, aktivizmin dhe përfshirjen e të rinjve në komunitetet lokale - A mund ta bëjmë më mirë?*

Në konferencë morën pjesë më shumë se 120 përfaqësues të autoriteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia.

Instituti i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit (CDI) organizon edicionin e 5-të të Forumit të Lidhjes në Tiranë 2019 - "Weaving the fabric of the union"

Tiranë, 29 – 31 tetor 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në edicionin e 5-të të Forumit të Lidhjes në Tiranë 2019 – "Weaving the fabric of the union", i cili u mbajt në Hotel Rogner dhe u organizua nga Instituti i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit (CDI) në partneritet me Friedrich Ebert Stiftung–FES, Hanns Seidel Stiftung–HSS and Konrad Adenauer Stiftung–KAS;

në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Bashkëpunimit Rinor-RYCO, dhe; me mbështetjen e Samitit të Ballkanit Perëndimor në Poznan dhe të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal-RCC.

Në këtë aktivitet morën pjesë ekspertë, studiues, akademikë, koordinatorë të shoqërisë civile, WBS dhe politikë-bërës të tjerë të përfshirë në Zgjerimin e BE-së në WB6, në bashkëpunimin rajonal dhe dinamikat e lidhjes.

Ky edicion i forumit analizo përparimin e Agjendës së Lidhjes në transport dhe energji, si dhe lidhjes P2P, dhe më pas debatimin mbi rolin që kanë projektet e infrastrukturës së lidhjes në përmirësimin e qeverisjes institucionale të WB6, ankorimin e vendeve WB6 në rrugën e tyre në BE, si dhe ndihmën për reformat institucionale të angazhuara të BB6.

Programi ishte organizuar në gjashtë panele dhe projektuar për të mbuluar të dyja sektorin dhe dinamikat transversale:

- *Më 30 tetor – "Gjendja e Lidhjes në WB6", panelet mbuluan përbërësin hapësinor të Agjendës së Lidhjes në sektorët e energjisë dhe transportit, si dhe lidhjen P2P.*
- *Më 31 tetor – "Lidhja dhe konvergjenca", lidhja në rajonin e WB6 është analizuar në kontekstin më të madh të dinamikës së integritimit në BE dhe reformave.*

Mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Tiranë, 12 nëntor 2019



Mbahet mbledhja e radhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), e cila u organizua nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), pranë ambjenteve të Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD), në Kryeministri, ku kishte të ftuar organizata të shoqërisë civile.

Në këtë mbledhje u miratua Procesverbali i Mbledhjes së KKShC-së, të mbajtur më datë 22.6.2018; u diskutua mbi ndarjen e detyrimeve, ecurinë e KKShC-së në vazhdim dhe angazhimin e saj në monitorimin e VKM-së Nr. 539, datë 25.7.2019; Përfshirja e Shoqërisë Civile në Procesin e Negociatave; Organizimi i Konferencës së parë Kombëtare për Shoqërinë Civile; Ngritja e Grupit të Punës lidhur me Vullnetarizmin.

Vizitë studimore e OShC-ve pjesëmarrëse të Akademisë së OJF-ve

Tiranë, 21 nëntor 2019



Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në kuadër të Programit të Akademisë së OJF-ve për Organizatat e Shoqërisë Civile - nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, organizoi një takim pranë zyrave të institucionit me organizata të shoqërisë civile pjesëmarrëse të këtij programi.

Akademia është një program 9-mujor i dedikuar për Drejtues dhe Manaxherë të lartë të organizatave të shoqërisë civile, i cili synon rritjen e kapacitetit të tyre në manaxhimin organizativ dhe zhvillimin e qëndrueshëm të organizates.

Përfaqësuesit e AMSHC-së bënë një prezantim të shkurtër të rolit dhe veprimtarisë së institucionit, Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) dhe Udhërrëfyesin si edhe u diskutuan me të ftuarit mbi këto tema.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) prezanton Indeksin e Qëndrueshmërisë së OShC-ve: Raporti për Shqipërinë 2018

Tiranë, 22 nëntor 2019

Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në takim prezantues të "Indeksit të USAID për Qëndrueshmërinë së OShC-ve: Raporti për Shqipërinë 2018", të organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), i cili u mbajt pranë ambjenteve të Hotel Tirana International.

Në këtë panel diskutimi morën pjesëmarrës nga shoqëria civile, komuniteti i donatorëve, aktorët shtetërorë dhe pjesëmarrës nga media, të cilët së bashku diskutuan tendencat në qëndrueshmërinë e sektorit.

Qëndrueshmëria e përgjithshme e sektorit të shoqërisë civile nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2018, megjithëse përmirësime të vogla u vunë re në dimensionet e advokimit dhe të qëndrueshmërisë financiare.



Për më shumë informacion: www.idmalbania.org

AMSHC mbështet nismën #ShqipëriaSolidare për situatën e krijuar nga goditja e tërmetit

Nëntor – Dhjetor 2019

Menjëherë pas goditjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, Qeveria Shqiptare inicioi nismën "Shqipëria Solidare", ku

nëpërmjet një adrese të vetme online www.e-albania.al çdo shqiptar mund të kontribuojë në lehtësimin e pasojave të tërmetit shkatërrues.



Të gjitha kontributet e ndihmat do të adresohen nga struktura e posaçme shtetërore e Emergjencës Civile, për të lehtësuar dhe mbështetur qytetarët dhe familjet e prekura nga kjo fatkeqësi natyrore madhore.



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në kuadër të menaxhimit të gjendjes së jashtëzakonshme që ndodhi në vendin tonë për shkak të situatës së tërmetit, përveç solidarizimit ftoi edhe vullnetarë të profilit të psikologjisë t'i bashkohen nismës #ShqipëriaSolidare për orientimin dhe këshillimin e prindërve në familje në rast tërmeti.

Në solidaritet dhe përgjigje të kësaj nisme, në fillim të muajit Dhjetor 2019, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) publikoi online në faqen zyrtare www.amshc.gov.al dhe rrjete sociale një përmbledhje me titull "Këshilla për Prindërit në Familje në Rast Tërmeti" të pyetjeve dhe përgjigjeve nga disa vullnetarë dhe ekspertë të profilit të psikologjisë. Gjithashtu çdo i interesuar për këshilla të mëtejshme, u ftua të kontaktojë AMShC-në në kutinë e mesazheve "inbox" të rrjetit social Facebook apo adresës e-mail të AMSHC-së, ku do të njoftohej menjëherë për shqetësimin e tij.

Takime informuese dhe konsultimi mbi procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Nëntor - Dhjetor 2019

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) përgjatë muajve Nëntor – Dhjetor 2019 zhvilloi disa takime informuese dhe konsultimi mbi procesin e përzgjedhjes së katër anëtarëve të shoqërisë civile të KKShC-së me organizata të shoqërisë civile.

Vendet vakante të anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile në Këshill janë krijuar për shkak të përfundimit të mandateve 2-vjeçare, përkatësisht:

- **2 (dy) anëtarë për fushën e veprimit A;**
- **1 (një) anëtar për fushën e veprimit B.;**
- **1 (një) anëtar për fushën e veprimit C.**

Gjatë kësaj periudhe u realizuan takimet në Kukës dhe Berat, por për shkak të emergjencës së krijuar nga goditja e tërmetit të 26 nëntorit 2019, takimet e radhës u ndërpreën deri në një njoftim tjetër. Në takimet e zhvilluara, përfaqësuesit e AMShC-së dhe organizatave të shoqërisë civile diskutuan mbi kriteret për kandidatët, dokumentacionet mbështetëse dhe fazat e procesit për përzgjedhjen e kandidaturave për anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane (ISSH) prezanton studimin “Përshpejtim i zhvillimit dhe bashkëpunimit qytetar”

Tiranë, 17 dhjetor 2019



Përfaqësues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në prezantimin e studimit “Përshpejtim i zhvillimit dhe bashkëpunimit qytetar”, të realizuar nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane (ISSH) me përkrahjen e USAID, në kuadër të projektit “Përmirësimi i politikave lokale të qeverisjes, nëpërmjet pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve”.

Gjetjet e studimit i prezantoi Drejtori Ekzekutiv i Institutit z. Leart Kola, ndërsa qëndrimet e Ministrisë së Brendshme i prezantoi Zv.Ministrja znj. Romina Kuko, e cila iu përgjigj gjithashtu pyetjeve të pjesëmarrësve lidhur me decentralizimin dhe ndryshimet, që ka sjellë

reforma administrativo-territoriale e vitit 2013 si dhe procesin e regjistrimit dhe sinjalizimit të adresave.

Prezente në panel ishte edhe Nënkryetarja e Bashkisë Tiranë znj. Anuela Ristani, e cila iu përgjigj interesit të pjesëmarrësve, ndër të tjera edhe mbi çështjen e centralizimit të një pjese të funksioneve pranë bashkive. Kjo çështje ka bërë që disa procedura të kenë ende nevojë për përmirësim. Sugjerimi i propozuar ishte përpilimi nga ana e bashkisë i formularëve standarde për ankesa/kërkesa të ndryshme, për t’ia lehtësuar komunikimin qytetarëve me institucionin.

Ky studim tenton të përmirësojë politikat lokale të qeverisjes, nëpërmjet pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve si dhe për t’iu shërbyer më mirë nevojave të qytetarëve, me fokus të veçantë grupet vulnerabël.

Për realizimin e studimit një grup ekspertësh të fushave të ndryshme kanë bashkëpunuar për gjatë një viti duke marrë në analizë bashkitë: Tiranë, Lezhë, Peshkopi, Korçë dhe Sarandë.